



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 1-23 / Prot.
1

Tiranë, më 01 / 06 / 2020

URDHËR

Nr. 156 datë 01 / 06 . 2020

**“PËR
PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM TË CERTIFIKATËS PËRMBARIMORE TË
PËRMBARUESES INA BARJAMAJ”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 26, pika 3, të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat”, si dhe të pikës 5, të Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë nr.137, datë 27.04.2020 “Për miratimin e rregullave të hollësishtme për dokumentacionin dhe procedurën e shqyrtimit të kërkesës për pezullimin e përkohshëm”,

KONSTATOJ:

Përmbarruesja gjyqësore private i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me kërkesën drejtuar I-136 Prot., datë 01.10.2019 dhe kërkesën me nr.I-136/1 Prot., datë 04.11.2019, përmes së cilës ka kërkuar pezullimin e përkohshëm të certifikatës përmbarrimore, për shkak se me vendimin nr.196, datë 02.10.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur kualifikimin e saj për formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për profilin gjyqtar.

Në nenin 26, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr.26/2019 “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat”, parashikohet se: “Përmbarruesi ka të drejtë të ndërpresë ushtrimin e profesionit dhe të kalojë në statusin pasiv për arsyet e mëposhtme: ... zgjedhjes ose emërimit në një funksion publik”.

Gjithashtu, nga ana e znj.Barjamaj është përcaktuar dhe përmbarruesi gjyqësor privat zëvendësues, znj.Ardiana Gjoka.

Me shkresën nr.I-21/3 Prot., datë 15.05.2020, Dhoma Kombëtare e Përmbarruesve Gjyqësorë Privatë ka vlerësuar se kërkesa e paraqitur duhet pranuar.

Bazuar sa më sipër, referuar kërkesës së përmbarrueses gjyqësore private, lind e nevojshme pezullimi i certifikatës përmbarrimore e përmbarrueses gjyqësore private Ina Barjamaj.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 26, pika 3, të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”, si dhe të pikës 5, të Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë nr.137, datë 27.04.2020 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shqyrtimit të kërkesës për pezullimin e përkohshëm”,

URDHËROJ:

1. Pezullimin e certifikatës së ushtrimit të veprimtarisë përbarimore, përbarueses gjyqësore private Ina Barjamaj.
2. Njoftimin e menjëhershëm të pezullimit të certifikatës së ushtrimit të veprimtarisë përbarimore shtetases Ina Barjamaj dhe Dhomës Kombëtare të Përbaruesve Gjyqësorë Privatë.
3. Dorëzimin brenda 3 (tre) ditësh pranë strukturës përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë, të vulës personale, me qëllim marrjen dhe asgjësimin e saj.
4. Regjistrimin e këtij Urdhri në Regjistrin e Përbaruesve Gjyqësorë Privatë pranë Ministrisë së Drejtësisë, nga struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë, si dhe publikimin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.
5. Caktimin e përbaruesit gjyqësor privat zëvendësues, Ardiana Gjoka.
6. Marrjen e masave nga ana e përbarueses gjyqësore private Ina Barjamaj për dorëzimin e dokumentacionit i cili do jetë në ngarkim të Ardiana Gjoka, njoftimin për vijimin, vazhdimin dhe ndjekjen e procedurave përbarimore të palëve në çështjen përbarimore jo më vonë se 3 (tre) ditë pune nga fillimi i zëvendësimit, nëpërmjet pasqyrit në një procesverbal, i cili i përcillet për njohje Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Përbaruesve Gjyqësorë Privatë, mbi dosjet përbarimore të cilat do jenë në ngarkim të Ardiana Gjoka.
7. Marrjen e masave nga përbaruesja gjyqësore private Ina Barjamaj, me qëllim kalimin dhe lejimin e përbarueses gjyqësore private zëvendësuese Ardiana Gjoka, mbi aksesin e plotë për çështjet përbarimore që janë në ekzekutim aktiv vazhdues dhe/ose çështjet që janë të pezulluara, që sipas kërkesës së subjektit kreditor vlerësohet se duhet të rifillojnë nga përbaruesi gjyqësor privat zëvendësues apo detyrohen të rifillojnë sipas një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

8. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë të marrin masat e nevojshme për zbatimin dhe njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Etilda Gjonaj (Saliu)

